



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

U D H Ë Z I M

Nr. ____, datë __.__.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT, PËRMBAJTJES, MËNYRËS SË
PARAQITJES DHE SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR REGJISTRIM NË
REGJISTRIN E LOBIMIT**

Në mbështetje të pikës 7 të nenit 9 të ligjit nr. 12/2026, datë 28.01.2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”),

U D H Ë Z O N:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Ky udhëzim përcakton formatin, përmbajtjen, mënyrën e paraqitjes dhe shqyrtimit të kërkesës për regjistrim në Regjistrin e Lobimit (në vijim “Regjistri”), dokumentacionin e detyrueshëm që i bashkëlidhet kërkesës dhe procedurën e vendimmarrjes nga Komisioneri.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi është të standardizojë procedurën e regjistrimit në Regjistër, në përputhje me Ligjin, duke garantuar trajtim të njëjtë të kërkesave, saktësinë e të dhënave, transparencën e procedurës dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

**Neni 3
Fusha e zbatimit**

1. Ky udhëzim zbatohet për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që paraqesin kërkesë për regjistrim në Regjistër, në përputhje me Ligjin.

2. Ky udhëzim zbatohet gjithashtu për strukturën përgjegjëse të Komisionerit, të ngarkuar me marrjen, verifikimin, shqyrtimin dhe vendimmarrjen mbi kërkesat për regjistrim, si dhe administrimin e dokumentacionit përkatës.

KREU II

KËRKESA PËR REGJISTRIM DHE DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM

Neni 4

Mënyra e paraqitjes së kërkesës

1. Kërkesa për regjistrim paraqitet pranë Komisionerit në formë elektronike ose nëpërmjet shërbimit postar, në përputhje me nenin 9, pika 1, të Ligjit.
2. Kërkesa konsiderohet e paraqitur:
 - a) në datën e mbërritjes në adresën elektronike të Komisionerit, kur paraqitet në formë elektronike;
 - b) në datën e depozitimit, sipas vulës postare, kur paraqitet nëpërmjet shërbimit postar.
3. Kërkesa paraqitet e plotë dhe e nënshkruar nga kërkuesi ose personi i autorizuar ligjërisht për ta përfaqësuar atë.
4. Çdo komunikim i mëvonshëm ndërmjet Komisionerit dhe kërkuesit kryhet nëpërmjet kanalit të komunikimit të deklaruar në kërkesën për regjistrim.

Neni 5

Formularët standardë

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi miratohen formularët standardë, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të tij, si më poshtë:
 - a) kërkesë e personit fizik për regjistrim – **Formulari A**;
 - b) kërkesë e personit juridik për regjistrim – **Formulari B**;
 - c) vetëdeklarim i personit fizik – **Formulari C**;
 - ç) vetëdeklarim i personit juridik – **Formulari D**;
 - d) kërkesë për çregjistrim – **Formulari E**.
2. Formularët standardë plotësohen në mënyrë të lexueshme dhe në përputhje me kërkesat e tyre. Mungesa e të dhënave në fushat e detyrueshme ose mospërputhja ndërmjet të dhënave të deklaruara dhe dokumentacionit shoqërues, përbën shkak për kërkimin e plotësimit të dokumentacionit, në përputhje me nenin 9, pika 4, të Ligjit.
3. Formularët standardë mund të përshtaten teknikisht për përdorim në sistemin elektronik të Regjistrimit, pa ndryshuar përmbajtjen e tyre detyruese të miratuar me këtë udhëzim.
4. Formularët standardë plotësohen në gjuhën shqipe. Dokumentet e hartuara në gjuhë të huaj paraqiten në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
5. Formularët standardë publikohen në faqen zyrtare të Komisionerit.

Neni 6
Dokumentacioni i detyrueshëm për personin fizik

1. Personi fizik që kërkon të regjistrohet në Regjistër paraqet, bashkë me kërkesën (Formulari A), edhe dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) kopje të dokumentit të vlefshëm të identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë);
 - b) vetëdeklarim sipas Formularit C për mungesën e ndalimeve të parashikuara në nenin 5 të Ligjit;
 - c) të dhënat e kontaktit dhe adresën postare ose elektronike për komunikim zyrtar;
 - ç) përshkrimin e fushës dhe temave kryesore në të cilat do të ushtrohet veprimtaria e lobimit.

Neni 7
Dokumentacioni i detyrueshëm për personin juridik

1. Personi juridik që kërkon regjistrim paraqet, bashkë me kërkesën (Formulari B), edhe dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) ekstrakt zyrtar të përditësuar të regjistrimit të personit juridik;
 - b) të dhënat identifikuese të përfaqësuesit ligjor;
 - c) të dhënat identifikuese të personave të autorizuar që kryejnë veprimtari lobimi në emër të personit juridik;
 - ç) vetëdeklarim sipas Formularit D për mungesën e ndalimeve të parashikuara në nenin 5 të Ligjit, i nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor.
2. Dokumentacioni i paraqitur nga personat juridikë të huaj paraqitet në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar për njohjen dhe vlefshmërinë e dokumenteve të huaja.

KREU III
SHQYRTIMI PARAPRAK, SHQYRTIMI NË THEMEL DHE
VENDIMMARRJA

Neni 8
Regjistrimi i kërkesës

1. Pas paraqitjes së kërkesës, struktura përgjegjëse e Komisionerit e regjistron atë në sistemin e protokollit dhe i cakton një numër protokolli.
2. Regjistrimi i kërkesës i konfirmohet kërkuarit nëpërmjet kanaleve të komunikimit të deklaruara në kërkesë.
3. Numri i protokollit përbën referencën zyrtare për të gjithë komunikimin e mëvonshëm në lidhje me kërkesën.

Neni 9
Shqyrtimi paraparak i kërkesës

1. Shqyrtimi paraparak i kërkesës përfshin:

- a) verifikimin, nëse kërkesa është paraqitur sipas formularit standard përkatës dhe përmban të dhënat e kërkuara;
 - b) konstatimin e ekzistencës së dokumenteve të detyrueshme, sipas neneve 6 dhe 7 të këtij udhëzimi;
2. Kur kërkesa është e paplotë ose ka paqartësi, struktura përgjegjëse brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e kërkesës, i kërkon kërkuarit plotësimin e dokumentacionit në përputhje me pikën 4 të nenit 9 të Ligjit.
- Kërkesa për plotësim:
- a) bëhet me shkrim dhe specifikon dokumentet ose elementet që mungojnë;
 - b) regjistrohet si pjesë e dokumentacionit administrativ të procedurës;
 - c) pezullon afatin e shqyrtimit deri në paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar.
3. Kërkuari plotëson dokumentacionin brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja e njoftimit. Mosplotësimi i dokumentacionit brenda afatit përbën shkak për refuzimin e kërkesës për regjistrim, pa cenuar të drejtën e lobistit për të paraqitur një kërkesë të re në përputhje me Ligjin dhe këtë udhëzim.

Neni 10

Shqyrtimi në themel

1. Pas përfundimit të shqyrtimit paraprak, struktura përgjegjëse kryen shqyrtimin në themel të kërkesës në përputhje me afatin e përcaktuar në pikën 4 të nenit 9 të Ligjit.
2. Shqyrtimi në themel përfshin:
 - a) konstatimin e plotësimit të kushteve ligjore për regjistrim, në përputhje me Ligjin;
 - b) konstatimin e mungesës së ndalimeve ose pengesave ligjore për regjistrim, sipas Ligjit;
 - c) verifikimin e autorizimeve të paraqitura, kur subjekti është person juridik;
 - ç) përputhjen e të dhënave të deklaruara me dokumentacionin shoqërues.
3. Për verifikimin e të dhënave të paraqitura, Komisioneri mund të kërkojë informacion nga autoritetet kompetente, sipas shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 7 të Ligjit.
4. Kur gjatë shqyrtimit konstatohen rrethana që mund të ndikojnë në vendimmarrje, Komisioneri njofton kërkuarin për këto rrethana dhe i jep mundësinë të paraqesë shpjegime brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e njoftimit.

Neni 11

Vendimmarrja

1. Komisioneri vendos për regjistrimin ose refuzimin e kërkesës brenda afatit të përcaktuar në pikën 4 të nenit 9 të Ligjit, mbi bazën e dokumentacionit të administruar dhe verifikimeve të kryera.
2. Vendimi për regjistrimin hartohet dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionerit, sipas pikës 6 të nenit 9 të Ligjit.
3. Vendimi për refuzimin e kërkesës arsyetohet dhe i komunikohet kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 9 të Ligjit dhe legjislacionin procedural në fuqi.

KREU IV

NJOFTIMI I VENDIMIT

Neni 12

Njoftimi i vendimit dhe pasqyrimi në Regjistër

1. Vendimi i komunikohet lobistit nëpërmjet mënyrës së komunikimit të deklaruar në kërkesë.
2. Pas marrjes së vendimit për regjistrim, të dhënat përkatëse pasqyrohen në Regjistër.
3. Regjistri përmban të dhënat publike të parashikuara në pikën 3 të nenit 8 të Ligjit.

KREU V

ANKIMI ADMINISTRATIV DHE GJYQËSOR

Neni 13

Ankimi

1. Kundër vendimit të Komisionerit mund të paraqitet ankim administrativ, në përputhje me nenin 10 të Ligjit.
2. Vendimi i Komisionerit mund të ankimohet në gjykatën administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të Ligjit dhe legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14

Dispozitë tranzitore

Deri në vënien në funksion të sistemit elektronik të Regjistrit, kërkesat, dokumentacioni dhe komunikimet sipas këtij udhëzimi paraqiten në formë elektronike, në adresën zyrtare të postës elektronike të Komisionerit, nëpërmjet shërbimit postar ose fizikisht pranë zyrës së protokollit të Komisionerit, në përputhje me Ligjin dhe legjislacionin procedural në fuqi.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

A N E K S
FORMULARËT STANDARDË

FORMULARI A – KËRKESË PËR REGJISTRIM (PERSON FIZIK)

Drejtuar: Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Unë, i/e nënshkruar _____, paraqes këtë kërkesë për regjistrim në Regjistrin e Lobimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”.

Emri, mbiemri _____

Nr. personal / Pasaportë _____

Shtetësia _____

Datëlindja _____

Adresa e ushtrimit të veprimtarisë së lobimit _____

Telefon _____

Adresë elektronike (e-mail) _____

Fusha e veprimtarisë së lobimit (zgjidhni një ose më shumë):

- ☐ Punësimi
- ☐ Politika e Jashtme dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare
- ☐ Ekonomia
- ☐ Energjia
- ☐ Infrastruktura
- ☐ Bujqësia
- ☐ Mjedisi
- ☐ Arsimi, shkenca dhe inovacioni
- ☐ Kultura, rinia dhe sporti
- ☐ Politika e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare
- ☐ Siguria dhe mbrojtja
- ☐ Teknologjia dhe komunikimet elektronike
- ☐ Tjetër: _____

Tema/t kryesore në të cilat synohet të ushtrohet veprimtaria e lobimit:

Autoriteti/et publik/e ndaj të cilit/cilëve synohet të ushtrohet veprimtaria e lobimit (plotësohet vetëm nëse dihet në momentin e paraqitjes së kërkesës)

Përfituesi i lobimit (plotësohet vetëm kur është i njohur në momentin e paraqitjes së kërkesës)

Mënyra e preferuar e komunikimit:

☐ E-mail

☐ Postë

☐ Tjetër: _____

Dokumentacioni i bashkëlidhur:

☐ Kopje e dokumentit të vlefshëm të identifikimit

☐ Vetëdeklarim (Formulari C)

☐ Dokumentacion tjetër (kur është i zbatueshëm): _____

Deklaratë

Deklaroj se të dhënat dhe dokumentacioni i paraqitur janë të sakta, të plota dhe të vërteta dhe jam i vetëdijshëm se paraqitja e të dhënave të rreme sjell përgjegjësitë e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Vendi: _____

Data: _____

Emri dhe mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

FORMULARI B – KËRKESË PËR REGJISTRIM (PERSON JURIDIK)

Drejtuar: Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Unë, i/e nënshkruar _____, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të personit juridik të mëposhtëm, paraqes këtë kërkesë për regjistrim në Regjistrin e Lobimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”.

Emërtimi i personit juridik _____

NUIS ose numri ekuivalent i identifikimit të huaj (kur është i zbatueshëm)

Selia (adresa ligjore) _____

Forma juridike _____

Përfaqësuesi ligjor (emër, mbiemër, funksion) _____

Telefon _____

Adresë elektronike (e-mail) _____

Fusha e veprimtarisë së lobimit (zgjidhni një ose më shumë)

- ☐ Punësimi
- ☐ Politika e Jashtme dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare
- ☐ Ekonomia
- ☐ Energjia
- ☐ Infrastruktura
- ☐ Bujqësia
- ☐ Mjedisi
- ☐ Arsimi, shkenca dhe inovacioni
- ☐ Kultura, rinia dhe sporti
- ☐ Siguria dhe mbrojtja
- ☐ Teknologjia dhe komunikimet elektronike
- ☐ Tjetër: _____

Tema/t kryesore në të cilat synohet të ushtrohet veprimtaria e lobimit:

Autoriteti/et publik/e ndaj të cilit/cilëve synohet të ushtrohet veprimtaria e lobimit (plotësohet vetëm nëse dihet në momentin e paraqitjes së kërkesës)

Përfituesi i lobimit (plotësohet vetëm kur është i njohur në momentin e paraqitjes së kërkesës) _____

Mënyra e preferuar e komunikimit:

☐ E-mail

☐ Postë

☐ Tjetër: _____

Dokumentacioni i bashkëlidhur:

☐ Ekstrakt zyrtar i përditësuar i regjistrimit

☐ Dokument që provon cilësinë e përfaqësuesit ligjor

☐ Dokument që provon autorizimin e personit/personave që kryejnë veprimtari lobimi në emër të personit juridik

☐ Vetëdeklarim (Formulari D)

☐ Dokumentacion tjetër (kur është i zbatueshëm): _____

Deklaratë

Deklaroj se të dhënat dhe dokumentacioni i paraqitur janë të sakta, të plota dhe të vërteta dhe jam i vetëdijshëm se paraqitja e të dhënave të rreme sjell përgjegjësitë e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Vendi: _____

Data: _____

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor: _____

Nënshkrimi: _____

Vula (kur përdoret): _____

FORMULARI C – VETËDEKLARIM (PERSON FIZIK)

Unë, i/e nënshkruar _____, me nr. personal/dokument identifikimi _____, deklaroj me përgjegjësi të plotë se:

1. Plotësoj kushtet ligjore për regjistrim në Regjistrin e Lobimit, në përputhje me nenin 5 të ligjit nr. 12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”.
2. Nuk jam i/e dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për asnjërën nga veprat penale të parashikuara në nenin 5, pikat 2 dhe 3, të Ligjit.
3. Nuk ndodhem në asnjë nga rastet e ndalimit të parashikuara në nenin 5, pikat 5 dhe 7, të Ligjit.
4. Të dhënat dhe dokumentacioni i paraqitur janë të sakta, të plota dhe të vërteta.

Jam i/e ndërgjegjshëm/e se paraqitja e të dhënave të rreme në këtë deklaratë përbën shkelje administrative sipas nenit 24 të ligjit dhe, sipas rastit, mund të sjellë përgjegjësi penale.

Vendi: _____

Data: _____

Emri dhe mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

FORMULARI D – VETËDEKLARIM (PERSON JURIDIK)

Unë, i/e nënshkruar _____, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të personit juridik _____, me NUIS _____, deklaroj me përgjegjësi të plotë se:

1. Personi juridik nuk ndodhet në asnjë nga rastet e ndalimit të parashikuara në nenin 5, pikat 5, 6 dhe 7, të Ligjit.
2. Personat e autorizuar që kryejnë veprimtari lobimi në emër të personit juridik nuk ndodhen në asnjë nga rastet e ndalimit të parashikuara në nenin 5, pikat 2, 3, 5 dhe 7, të Ligjit.
3. Në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të personit juridik, deklaroj se nuk ndodhem në rastet e ndalimit ligjor të zbatueshme për mua, në përputhje me nenin 5 dhe nenin 9, pika 3, shkronja “c”, të Ligjit.
4. Të dhënat dhe dokumentacioni i paraqitur në kuadër të kërkesës për regjistrim janë të sakta, të plota dhe të vërteta.

Jam i/e ndërgjegjshëm/e se paraqitja e të dhënave të rreme në këtë deklaratë sjell pasojat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe, sipas rastit, mund të përbëjë shkak për çregjistrimin nga Regjistri i Lobimit, në përputhje me Ligjin.

Vendi: _____

Data: _____

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor: _____

Nënshkrimi: _____

Vula (kur përdoret): _____

FORMULARI E – KËRKESË PËR ÇREGJISTRIM NGA REGJISTRI I LOBIMIT

Drejtuar: Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Unë, i/e nënshkruar _____, paraqes këtë kërkesë për çregjistrim nga Regjistri i Lobimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”.

Emri / Emërtimi i lobistit _____

Numri i regjistrimit në Regjistrin e Lobimit _____

Nr. personal / NUIS _____

Përfaqësuesi ligjor (kur është person juridik) _____

Telefon _____

Adresë elektronike (e-mail) _____

Arsyeja e kërkesës për çregjistrim _____

Data e ndërprerjes së veprimtarisë së lobimit _____

Gjendja e detyrimeve të raportimit dhe deklarimit _____

Dokumentacioni i bashkëlidhur:

☐ Dokumentacion provues për arsyen e çregjistrimit (kur është i zbatueshëm)

☐ Dokumentacion tjetër (kur është i zbatueshëm): _____

Deklaratë

Deklaroj se të dhënat dhe dokumentacioni i paraqitur janë të sakta, të plotë dhe të vërteta dhe jam i vetëdijshëm se paraqitja e të dhënave të rreme sjell përgjegjësitë e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Vendi: _____

Data: _____

Emri dhe mbiemri / Emërtimi: _____

Nënshkrimi: _____

Vula (kur përdoret): _____